



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT**

**Seksioni për oraganet e administratës qendrore, të pushtetit vendor dhe të të tretëve që
veprojnë për llogari të tyre**

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok.202300552/5

Tiranë ___/___/2023

Lënda : *Rekomandohet marrja e masave të menjëhershme për ndërtimin e sistemit të kanalizimeve për shkarkimin e ujrave të zeza në fshatin Gjashtë, Bashkia Sarandë.*

Drejtuar: Bashkisë

SARANDË

Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit

TIRANË

Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë

TIRANË

Për dijeni: Andon Vasili

Adresa: Gjashtë

SARANDË

Të nderuar,

Në institucionin e Avokatit të Popullit ka paraqitur një ankesë shtetasi Andon Vasili me banim në fshatin Gjashtë, Sarandë. Në këtë ankesë ai ngre shqetësimin për ndotjen e ambientit në zonën e banimit të tij, e cila shkaktohet nga mos ndërhyrja e Bashkisë Sarandë për disiplinimin e ujërave të zeza.

Gjithashtu ankuesi shkruan se për zgjidhjen e këtij shqetësimi i është drejtuar me kërkesë padi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Pas gjykimit të çështjes, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë me vendimin nr.23-2016-1945 (1019), datë 17.10.2016 ka vendosur:

“Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë së paditësit Andon Vasili.

Detyrimin e palës së paditur Bashkia Sarandë, që të sistemojë ujërat e bardha dhe të zeza që vijnë nga prona e të paditurit Qemal Piro, duke i sistemuar ato në kanalën e ujërave të zeza të fshatit Gjashtë.

Detyrohet i padituri Qemal Piro që të mbledhë ujërat e bardha dhe të zeza dhe t'i sistemojë për t'u derdhur në kanalën që do të hapë Bashkia Sarandë, për sistemimin e ujërave, duke mos i derdhur pas sistemimit të ujërave nga Bashkia Sarandë, në pronën e paditësit....”.

Ndërkohë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, në datën 17.10.2016 ka nxjerrë edhe urdhrin e ekzekutimit të këtij vendimi, i cili do të vihet në ekzekutim nga përmbaruesi gjyqësor vetëm pasi vendimi nr.23-2016-1945 (1019), datë 17.10.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, të marrë formë të prerë. Në datën 09.11.2016, vendimi ka marrë formë të prerë dhe pas kësaj date ankuesi ka vënë në lëvizje përmbaruesin gjyqësor për të bërë të mundur ekzekutimin e tij.

Ankuesi pretendon, se nga përmbaruesi gjyqësor i janë dërguar disa shkresa Bashkisë Sarandë, por ajo nuk e ekzekutoi vendimin gjyqësor të cituar më sipër.

Për të bërë të mundur shqyrtimin e kësaj ankese, nga ana jonë i'u kërkua informacion Bashkisë Sarandë, lidhur me pretendimet e ngritura nga ankuesi dhe për shkaqet e mos ekzekutimit të këtij vendimi gjyqësor.

Në vijim të kërkesës tonë, Bashkia Sarandë me shkresën nr.2906/1 prot, datë 07.07.2023, ndërmjet të tjerave na informoi, se:

“... Bashkia Sarandë, ka verifikuar situatën në terren me synim kryerjen e veprimeve procedurale për ekzekutimin e vendimit gjyqësor me nr.23-2016-1945 (1019), datë 17.10.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

Ju informojmë se Bashkia Sarandë, nuk mund ta ekzekutojë vendimin për faktin se gjatë verifikimit në terren është konstatuar se gropa septike dhe prona e palës të paditur për të cilën kërkohet lidhja me sistemin e kanalizimeve të ujërave të zeza të fshatit Gjashtë, shtrihet në një zonë që nuk e ka një sistem të tillë të ndërtuar.

Ekzekutimi i këtij vendimi do të kërkonte projekt në tërësi të gjithë fshatit Gjashtë, për ndërtimin e sistemit të kanalizimeve të ujërave të zeza dhe për rrjedhojë do të kërkonte alokimin e një fondi dhe kryerjen e një investimi të konsiderueshëm nga ana e organeve kompetente.

E gjithë zona është me gropa septike dhe mundësi për investim të këtij niveli nuk ka, për rrjedhojë, vendimi gjykatës bëhet i paekzekutueshëm në formën e kërkuar nga kreditori dhe përmbaruesi gjyqësor privat z. Bujar Shehu”.

Nga përgjigjja e Bashkisë Sarandë, kuptohet qartë se shkak për mos ekzekutimin e vendimit të gjykatës është mungesa e rrjetit/sistemit të kanalizimit të ujërave të zeza në zonën ku ndodhet banesa e ankuesit dhe mungesa e fondeve për kryerjen e një investimi të tillë.

Gjithashtu, në këtë përgjigje Bashkia na informoi se çështja që ngre ankuesi është problematikë që shqetëson gjithë komunitetin e banorëve të fshatit Gjashtë, Sarandë.

Nga sa parashtruam më sipër, rezulton se, ndaj Bashkisë Sarandë është vendosur një detyrim me vendimin gjyqësor të cituar më sipër, që të sistemojë ujërat e bardha dhe të zeza që vijnë nga prona e të paditurit Qemal Piro, duke i sistemuar ato në kanalin e ujërave të zeza të fshatit Gjashtë. Theksojmë se në bazë të nenit 142, pika 3¹, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, respektivisht neneve 510 e në vijim, Bashkia Sarandë është e detyruar që ta zbatojë vendimin e gjykatës. Ndërkohë referuar përgjigjes së saj, rezulton se ajo gjendet në kushtet e pamundësisë për ta zbatuar vendimin gjyqësor për shkak të mungesës së rrjetit/sistemit të kanalizimit të ujërave të zeza në zonën ku ndodhet banesa e ankuesit dhe të mungesës së fondeve.

Ndodhur në këto rrethana, ne vlerësojmë, se nga Bashkia Sarandë **nuk** është vlerësuar sa e si duhet kjo problematikë, që, nuk është shqetësim vetëm për ankuesin, por për të gjithë banorët e zonës në të cilën banon ai. Ndërkohë nga përgjigja e Bashkisë **nuk** rezulton që ajo të jetë vënë në lëvizje dhe të ketë bërë përpjekje për të kërkuar e siguruar fondet e nevojshme pranë organeve të pushtetit qendror me qëllim bërjen e projektit dhe të investimit përkatës për të bërë të mundur zgjidhjen e këtij shqetësimi.

Avokati i Popullit vlerëson se edhe në rastet kur kërkon fonde të rëndësishme buxhetore, puna nis nga kërkimi i tyre dhe marrja e masave afat mesme për gjetjen dhe realizimin e tyre. Fakti që problematika ka mbi 10 vite që është ngritur dhe 7 vite për të cilën ka vendim gjyqësor, tregon se Bashkia nuk ka marrë masa për të zgjidhur këtë problem thelbësor të qytetarëve të fshatit Gjashtë.

Ne çmojmë se çështja objekt shqyrtimi është pjesë e objektivave sociale që synon të arrijë shteti brenda kompetencave të tij kushtetuese dhe mjeteve që ai disponon. Në nenin 59 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parashikohet synimi i shtetit për krijimin e një mjedisi të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm. Në funksion të këtij synimi, veprimtaria e organeve të pushtetit vendor dhe qendror është e detyrueshme të përqëndrohet në zgjidhjen e çështjeve të natyrës, sikurse është rasti në shqyrtim.

Ruajtja e mjedisit por mbi të gjitha të jetës dhe shëndetit të banorëve të fshatit Gjashtë, Sarandë, është detyrë parësore për organet e administratës publike të cilat në ushtrim të funksioneve dhe kompetencave të tyre mund dhe duhet të ndërmarrin masa për zgjidhjen e këtij problemi.

Referuar përgjigjes së dërguar nga Bashkia Sarandë, konstatohet se ndonëse kjo problematikë është e hershme, por nga institucionet përgjegjëse ende nuk është përgatitur

¹ 3.Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore.

një plan masash për zgjidhjen përfundimtare të saj. Në këtë kuptim, institucioni i Avokati i Popullit vlerëson, se institucionet përgjegjëse në ushtrim të funksioneve të tyre dhe bazuar në problematikën e konstatuar, duhet të kishin planifikuar shumë kohë më parë, planin e masave dhe buxhetin përkatës për kryerjen e investimeve në infrastrukturën e kësaj zone.

Agjencia Kombëtare e Ujësjiellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM), është krijuar në bazë të VKM-së nr.431, datë 11.07.2018 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjiellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve” dhe Urdhrit të Kryeministrit nr.13, datë 21.01.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Ujësjiellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve”, si dhe Urdhrit nr.88, datë 24.02.2020 “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjiellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve” të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë. Në këto akte nënligjore janë përcaktuar objekti i veprimtarisë dhe detyrat funksionale të kësaj agjencie. AKUM ka për objekt të veprimtarisë së saj në fushat e përgjegjësisë sipas përcaktimeve të bëra në VKM-në nr.431, datë 11.07.2018, pika 3, 11 dhe 12, në planifikimin e investimeve, koordinimin dhe monitorimin e të gjitha aktiviteteve sektorial të ujësjiellës-kanalizimeve, trajtimin e ujërave të ndotura, planifikimin territorial dhe infrastrukturën e mbetjeve dhe implementimin e tyre, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për infrastrukturën, si dhe gjithë bashkëpunimin me institucionet në nivel qendror dhe vendor apo aktorë të tjerë, nëpërmjet autoritetit të saj ligjor dhe teknik.

Ndër detyrat funksionale të përcaktuara në aktet ligjore të lartpërmendura për AKUM, janë:

-Përgatitja e planeve dhe nevojave për investime për ndërtimin/rehabilitimin/zgjerimin/përshtatjen e sistemeve dhe infrastrukturës së plotë të UK-së, si dhe planifikimin territorial respektiv, planifikimin e nevojave dhe implementimin e tyre për investime dhe planifikimin territorial në infrastrukturën e mbetjeve, si dhe për implementimin e tyre, bazuar në programet e qeverisë, masterplanet kombëtare sektoriale dhe dokumenta të tjerë strategjik në sektorët respektiv;

-Koordinon, nxit dhe bashkëpunon me institucionet shtetërore të nivelit qendror dhe lokal, institucionet financiare ndërkombëtare, investitorët dhe palët e tjera të interesuara sipas kuadrit ligjor, për zbatimin e strategjive të sektorit për shërbimet e ujësjiellës-kanalizimeve, trajtimin e ujërave të ndotura dhe planifikimin territorial si dhe infrastrukturën e mbetjeve;

-Përgatit metodologjinë dhe realizon shpërndarjen e subvencioneve të planifikuara në buxhetin e shtetit në sektorin e ujësjiellës-kanalizimeve, në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi;

-Është institucion përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e procedurave dhe të programit të monitorimit për shërbimet e furnizimit me ujë, të kanalizimeve dhe trajtimin e ujërave të ndotura si dhe infrastrukturën e mbetjeve;

-Ka të drejtë të jetë pjesë e subjektit të kompetencave të përbashkëta, sipas përcaktimeve të ligjit të vetëqeverisjes vendore; ...”.

Sjellim në vëmendje se për situatën e krijuar nga ndërtimet informale dhe pa kriter në zonën në fjalë, institucioni i Avokatit të Popullit, vlerëson se është përgjegjësi dhe neglizhencë e organeve qendrore dhe vendore, të cilët duhet të kishin marrë të gjitha masat e duhura për të kontrolluar dhe monitoruar territorin.

Sigurisht që edhe banorët të cilët kanë kryer ndërtime informale kanë përgjegjësinë e tyre, por tashmë pas më shumë se 20 vitesh situata duhet të nisë të sistemohet.

Sa më sipër, ushtrimi i detyrave funksionale nga subjektet publike dhe marrja e masave të menjëhershme për garantimin e një mjedisi të shëndetshëm, përbën nevojë emergjente duke patur parasysh dhe Direktivën Kuadër për Ujërat (2000/60/EC) dhe Direktivën për Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane (91/271/EEC) që synojnë mbrojtjen e shëndetit të njeriut.

Po ashtu, duke u fokusuar në njohjen e standardeve ndërkombëtare, theksojmë faktin se Rezoluta 64/292 e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, njeh të drejtën për ujë të pijshëm dhe kanalizime të sigurta dhe të pastërta, si një “e drejtë e njeriut” që është thelbësore për gëzimin e plotë të të gjitha të drejtave; Asambleja e Përgjithshme² u bën thirrje shteteve dhe organizatave ndërkombëtare që të ofrojnë burime financiare, ngritje kapacitetesh dhe transferim teknologjie, nëpërmjet ndihmës dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, veçanërisht për vendet në zhvillim, në mënyrë që të shtojnë përpjekjet për të siguruar ujë të pijshëm dhe kanalizime të sigurta, të pastërta, të aksesueshme për të gjithë.

Shqipëria është një nga vendet që ka nënshkruar Deklaratën e Mijëvjeçarit duke u angazhuar në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit deri në vitin 2015. Dhe në shtatëmbëdhjetë Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZHQ), të cilat kanë si afat vitin 2030. Në këtë axhendë të re të zhvillimit, uji dhe kanalizimet konsiderohen të kenë rol kyç në të gjitha dimensionet e zhvillimit të qëndrueshëm, për sa ato kanë lidhje me disa probleme kryesore globale dhe kanë ndikim në të gjitha aktivitetet njerëzore.

Ndër të tjera, për herë të parë në historinë e vet, Kombet e Bashkuara kanë pranuar se kushdo, kudo, ka të drejtë të jetojë në një mjedis të pastër, të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm³. Rezolutat nga Këshilli i të Drejtave të Njeriut në 2021 (A/HRC/RES/48/13) dhe Asambleja e Përgjithshme në 2022 (A/RES/76/300) e shtojnë këtë të drejtë themelore të njeriut në bibliotekën e të drejtave të njohura ndërkombëtarisht. *“Ndërsa njerëzimi përballet me një krizë planetare të paprecedentë, është shpresa jonë e vërtetë që e drejta për një mjedis të pastër, të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm do të*

² <https://digitallibrary.un.org/record/687002?ln=en>

³ <https://www.ohchr.org/en/special-procedures/sr-environment>

shërbejë si një katalizator për ndryshimet sistematike dhe transformuese për të prodhuar një të ardhme të drejtë dhe të qëndrueshme në harmoni me natyrën”.

Po ashtu, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e ka përfshirë në përmbajtjen e saj të drejtën “*për një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm*”, si synim të objektivave sociale dhe përgjegjësi të shtetit, brenda kompetencave të tij.

Në këtë kuadër, shëndeti i njeriut mund të shihet si urë lidhëse midis të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes së mjedisit, duke qenë objektivi parësor i të dy fushave të rregullimit. Të drejtat e njeriut ekzistojnë për të promovuar dhe mbrojtur mirëqenien njerëzore, për të lejuar zhvillimin e plotë të secilit person dhe maksimizimin e qëllimeve dhe interesave të personit, individualisht dhe në bashkësi me të tjerët. Parakusht për shëndetin janë mjedise të sigurta, p.sh ajri, uji dhe toka. Ndotja ndikon në klimë, e cila nga ana tjetër fillon me një sërë reagimesh që rezultojnë në fatkeqësi natyrore. Ajo shkatërron shëndetin dhe vret, kështu që jo vetëm që shkatërron mjedisin, por shkel edhe të drejtat e njeriut.

Duke e trajtuar këtë çështje në një këndvështrim më specifik, eidentojmë se Bashkia Sarandë, ushtron në përputhje me legjislacionin në fuqi, funksionet dhe kompetencat (të njohura ndryshe si “*Funksione të veta*”), që ajo gëzon si njësi bazë e vetëqeverisjes vendore, nga ligji nr.139/2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”.

Kjo Bashki është përgjegjëse për realizimin e këtyre funksioneve (ushtrimin e kompetencave), si dhe ka lirinë dhe autoritetin të marrë vendime e të përdorë mjete për këtë qëllim, brenda hapësirës së normave, kritereve dhe standardeve të pranuar përgjithësisht me ligj, duke zotëruar autoritet të plotë administrativ, për të kryer shërbime, investime dhe rregullime.

Një ndër funksionet e veta të Bashkisë Sarandë në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, në përputhje me përcaktimin e dhënë në neni 23, të ligjit nr.139/2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”, është: “*...bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për: Prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm, mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura, mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut dhe mbrojtjen nga përmbytjet në zonat e banuara...*”

Njësitë e vetëqeverisjes vendore mbështeten në veprimtarinë e tyre të përditshme pikërisht në konceptin e *autonomisë vendore*, të kuptuar si, “*... e drejta dhe aftësia e njësisve të qeverisjes vendore, të krijuara sipas Kushtetutës dhe këtij ligji dhe në kuadër të kufizimeve të tij, që të rregullojnë dhe të administrojnë një pjesë thelbësore të çështjeve publike nën përgjegjësinë e tyre dhe në interes të bashkësisë*”, siç parashikohet në nenin 2/2, të ligjit nr.139/2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”.

Një rol të rëndësishëm në ushtrimin e kompetencave për mirëmbajtjen e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe të impianteve të pastrimit të tyre, luan edhe Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime sh.a Sarandë, e cila ka si mision të punës së saj, përmirësimin e

menaxhimit në Sektorin e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve në atë zonë, për ta bërë atë më eficient, të qëndrueshëm dhe efektiv në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Për sa më sipër, Avokati i Popullit, vlerëson se Bashkia Sarandë, nëpërmjet Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime sh.a Sarandë, është autoriteti përgjegjës për furnizimin me ujë të pijshëm dhe trajtimin e ujërave të ndotura. Sipas VKM-së nr. 1304, datë 11.12.2009 “*Për furnizimin me ujë dhe kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës kanalizime sh.a*”, përcaktohet qartë se bashkia, ngarkon për funksionim dhe mirëmbajtje një shoqëri publike të licensuar nga Enti Rregullator Kombëtar i Ujit për shërbimet e ujësjellës kanalizimeve. Bashkitë që posedojnë 100% aksione të kësaj shoqërie, me anë të asamblesë së aksionerëve realizojnë vendimmarrjet e rëndësishme për UK sh.a, përcaktojnë natyrën dhe qëllimin e ndërmarrjes si edhe datën e zbatimit, zgjerimin ose riorganizimin e saj.

Shoqëria Ujësjellës Kanalizime sh.a Sarandë përfaqëson institucionin funksional dhe ekzekutiv që vepron në emër të Bashkisë Sarandë dhe që ka detyrimet dhe përgjegjësitë publike për shërbimet e furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve të ujërave të ndotura në qytetit.

Pra, të gjitha këto akte ligjore dhe nënligjore kërkojnë dhe kanë si kusht ushtrimin e detyrave funksionale të subjekteve të cituara më lart dhe marrjen e masave të menjëhershme për zgjidhjen afatgjatë të problemit të ujërave të ndotura në zonën e fshatit Gjashtë, Sarandë, në përputhje me standardet e kërkuara dhe si një nevojë emergjente për të mos cënuar në asnjë rast shëndetin e këtyre qytetarëve.

Çështja e mbrojtjes së mjedisit ka qenë në vëmendjen e vazhdueshme të institucionit të Avokatit të Popullit. Problematika që prezantohet në këtë rast është tepër serioze në drejtim të shëndetit të qytetarëve dhe megjithëse ekziston prej disa kohësh ende nuk janë marrë masat e duhura për zgjidhjen e saj dhe garantimit me cilësi të këtij shërbimi publik.

Për sa më sipër, nga informacioni i dhënë nga Bashkia Sarandë për këtë çështje, del e qartë se, zona e fshatit Gjashtë, Sarandë, ndodhet mes ndotjes së ujërave të zeza. Ndër të tjera, situata bëhet më problematike, duke marrë parasysh faktin se zona është e banueshme nga një komunitet i gjerë njerëzish. Për më tepër kjo problematikë ka çuar edhe në konflikte sociale dhe gjyqësore. Duke pasur një vendim gjyqësor, kjo çështje merr prioritet veç të tjerave edhe në kuptim të zbatimit të vendimeve gjyqësore veç të drejtës për mjedis të shëndetshëm si objektiv social, duke u diferencuar nga detyrimi i përgjithshëm.

Duke analizuar specifikën e këtij rasti dhe informacionin e dërguar nga ana e subjekteve shtetëror, gjykojmë se është thelbësore ndërmarrja e veprimeve konkrete dhe planifikimi i investimeve në infrastrukturë për zgjidhjen e situatës së krijuar e cila do të ndikonte në uljen e rrezikut të efekteve serioze në shëndetin publik dhe mjedisit në tërësi.

Në analizë të fakteve të mësipërme, institucioni i Avokatit të Popullit synon që jo vetëm të vërë në lëvizje organet kompetente, por dhe t'i sensibilizojë ato për vetë rëndësinë që

ka kjo problematikë. Për këto arsye kërkojmë marrjen e veprimeve konkrete për zgjidhjen përfundimtare të problemit sikurse është menaxhimi i ujërave të ndotura të cilat kanë ndikime negative në ekosistem dhe në turizëm.

Në këtë kuadër, duke patur parasysh se kjo është një çështje e rëndësishme për qytetarët, të cilëve duhet t'u grantohet e drejta për një mjedis të shëndetshëm, Avokati i Popullit dëshiron të sjellë në vëmendjen tuaj ushtrimin e detyrave funksionale dhe marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin e situatës së krijuar përmes investimeve në infrastrukturën e kanalizimeve në zonën e fshatit Gjashtë, Sarandë.

Referuar parashikimeve të nenit 23/2 të ligjit nr. 139/2015, *“Për vetëqeverisjen vendore”*, Bashkia Sarandë është përgjegjëse në territorin e juridiksionit të vetë, për mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura. Ndërkohë, në zbatim të parashikimit të kryer në nenin 30/6 të ligjit në fjalë, qeverisja qendrore garanton njësitë të vetëqeverisjes vendore, mbështetjen e nevojshme financiare për ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të deleguara.

Gjithashtu, Avokati i Popullit, konsideron se roli i këtyre institucioneve në evidentimin e problematikave dhe dhënien e zgjidhjeve duhet të jetë proaktiv e të garantojë njohjen e situatës në terren.

Praktika e derisotme për zgjidhjen e çështjeve të tilla, tregon se në pamundësi të mbështetjes së nevojshme financiare nga Buxheti i Shtetit, Këshilli i Ministrave, rast pas rasti, ka kryer lidhjen e marrveshjeve për financimin e projekteve mbi bazë të të cilave është zgjidhur problemi i mbledhjes, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura.

Për sa parashtuam më sipër dhe për zgjidhjen e kësaj problematike, bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga Administrata Publike...”*, si dhe në nenin 21/b të ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”* ju,

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të nevojshme për parashikimin në buxhetin e vitit 2024 të ndërtimit të një sistemi të ri kanalizimesh të ujërave të zeza në fshatin Gjashtë, Sarandë, me qëllim zgjidhjen përfundimtare të situatës së krijuar nga ndotja me ujërat e zeza.
2. Marrjen e masave të menjëhershme për ndërtimin e sistemit të kanalizimeve të ujërave të zeza në zonën e fshatit Qafë Gjashtë, Sarandë;

3. Marrjen e masave të nevojshme për të aplikuar në programe të ndryshme ndërkombëtare që ofrojnë mbështetje për trajtimin e ujërave të ndotura.

4. Marrjen e masave nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për mbështetjen e nevojshme financiare të Bashkisë Sarandë, për mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura në fshatin Gjashtë, Sarandë.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, na ktheni përgjigje brenda afatit 30 ditor sikurse parashikohet në nenin 22, të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

Në mungesë dhe me urdër

KOMISIONERI

Ahemet PRENÇI

Konc dhe Dak
A. Gjoleka
Datë 20.12.2023

Të nderuar!

Në Institucionin e Avokatit të Popullit, ka paraqitur në funksion të ushtrimit të kompetencave kushtetuese dhe ligjore, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të shtetasve nga veprimet apo mosveprimet e organeve të administratës publike, duke marrë shkas nga ankesa e shtetasit Andon Vasili, për ndotjen e ambientit në zonën e fshatit Qafë Gjashtë, Sarandë, nga mosdisiplinimi i ujrave të zeza në këtë zonë, në përputhje me nenin 13, të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ka ndër marrë shqyrtimin e kësaj çështjeje.

Referuar akteve të vëna në dispozicion prej ankuesit, konstatohet se për këtë çështje Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin civil të formës së prerë nr.23-2016-1945 (1019), datë 17.10.2016, ka vendosur për:

“Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë së paditësit Andon Vasili.

Detyrimin e palës së paditur Bashkia Sarandë, që të sistemojë ujrat e bardha dhe të zeza që vijnë nga prona e të paditurit Qemal Piro, duke i sistemuar ato në kanalin e ujrave të zeza të fshatit Gjashtë.

Detyrohet i padituri Qemal Piro që të mbledh ujrat e bardha dhe të zeza dhe t'i sistemojë për t'u derdhur në kanalin që do të hapë Bashkia Sarandë, për sistemimin e ujrave, duke mos i derdhur pas sistemimit të ujarve nga Bashkia Sarandë, në pronën e paditësit.

....”.

Në procesin e shqyrtimit të kësaj çështjeje, Bashkia Sarandë, në përgjigje të kërkesës së Institucionit të Avokatit të Popullit, për dhënie, informacioni dhe shpjegimesh rreth shkaqeve të cilat do të mund të justifikonin mosekzekutimin deri më sot të vendimit gjyqësor të lartpërmendur, me shkresën nr.2906/1 prot, datë 07.07.2023, informon Avokatin e Popullit, midis të tjerave, se:

“... Bashkia Sarandë,, ka verifikuar situatën në terren me synim kryerjen e veprimeve procedurale për ekzekutimin e vendimit gjyqësor me nr.23-2016-1945 (1019), datë 17.10.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

...

Ju informojmë se Bashkia Sarandë, ... nuk mund ta ekzekutojë vendimin për faktin se gjatë verifikimit në terren është konstatuar se gropa skeptike dhe prona e palës të paditur për të cilën kërkohet lidhja me sistemin e kanalizimeve të ujërave të zeza të fshatit Gjashtë, shtrihet në një zonë që nuk e ka një sistem të tillë të ndërtuar.

Ekzekutimi i këtij vendimi do të kërkonte projekt në tërësi të gjithë fshatit Gjashtë, për ndërtimin e sistemit të kanalizimeve të ujërave të zeza dhe për rrjedhojë do të kërkonte alokimin e një fondi dhe kryerjen e një investimi të konsiderueshëm nga ana e organeve kompetente.

E gjithë zona është me gropa skeptike dhe mundësi për investim të këtij niveli nuk ka, për rrjedhojë, vendimi gjykatës bëhet i paekzekutueshëm në formën e kërkuar nga kreditori dhe përmbaruesi gjyqësor privat z.Bujar Shehu”.

Referuar deklarimeve të Bashkisë Sarandë, kuptohet se pamundësia financiare apo mungesa e rrjetit/sistemit të kanalizimit të ujërave të zeza në zonën ku ndodhet banesa e ankuesit, është shkak që pamundëson ekzekutimin e detyrimit të vendosur në rrugë

gjqësore. Në informacionin e dhënë, konfirmohet se çështja që shqetëson ankuesin është problematikë që shqetëson gjithë komunitetin e banorëve të fshatit Qafë Gjashtë, Sarandë.

Bashkia Sarandë, në kushtet e ekzistencën së detyrimit të vendosur në rrugë gjyqësore ndaj saj, ka pasur dhe ka detyrimin e kryerjes së veprimeve për ekzekutimin e tij. Dhe se, në pamundësi për disponimin e fondeve për përmbushjen e detyrimit ka pasur dhe ka detyrimin e sigurimit të tyre. Kërkimi pranë organeve të pushtetit qendror i alokimit të fondeve për përmbushjen e detyrimit nuk konstatohet të jetë kryer, në kushtet e pamundësisë së krijimit të tyre nga vetë kjo Bashki.

Çështja objekt prezantimi, gjykojmë se është pjesë e objektivave social që synon shteti të arrijë brenda kompetencave të tij kushtetuese dhe mjeteve që ai disponon. Neni 59 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sanksionon synimin e shtetit për krijimin e një mjedisi të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm. Në funksion të këtij synimi, veprimtaria e organeve të pushtetit vendor dhe qendror është e detyrueshme të përqëndrohet në zgjidhjen e çështjeve të natyrës sikurse kjo objekt prezantimi.

Ruajtja e mjedisit por mbi të gjitha të jetës dhe shëndetit të banorëve të fshatit Qafë Gjashtë, Sarandë, është detyrë parësore për organet e administratës publike të cilat në ushtrim të funksioneve dhe kompetencave të tyre mund dhe duhet të ndërmarrin masa për zgjidhjen e këtij problemi.

Për sa më sipër, në vlerësim të përgjigjes së dhënë nga Bashkia Sarandë, konstatohet se ndonëse problematika është e hershme, rezulton se nga institucionet përgjegjëse akoma nuk është përgatitur një plan masash për zgjidhjen përfundimtare të saj. Në këtë kuptim, Institucioni Avokati i Popullit vlerëson, se institucionet përgjegjëse në ushtrim të funksioneve të tyre dhe bazuar në problematikën e konstatuar, duhet të kishin planifikuar shumë kohë më parë, planin e masave dhe buxhetin përkatës për investime në infrastrukturë.

Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM), krijuar mbi bazë të VKM-së nr.431, datë 11.07.2018 *“Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanaalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve”* dhe Urdhërit të Kryeministrit nr.13, datë 21.01.2019 *“Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanaalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve”* ka të përcaktuara në këto akte nënligjor, si dhe Udhërin nr.88, datë 24.02.2020 *“Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanaalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve”* të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, objektin e veprimtarisë si dhe detyrat funksionale. AKUM ka për objekt të veprimtarisë së saj në fushat e përgjigjesisë sipas përcaktimeve të bëra në VKM-në nr.431, datë 11.07.2018, pika 3, 11 dhe 12, në planifikimin e investimeve, koordinimin dhe monitorimin e të gjitha aktiviteteve sektorial të ujësjellës-kanalizimeve, trajtimin e ujrave të ndotura, planifikimin territorial dhe infrastrukturën e mbetjeve dhe implementimin e tyre, në bashkëpunim me Ministrinë

përgjegjëse për infrastrukturën, si dhe gjithë bashkëpunimin me institucionet në nivel qendror dhe vendor apo aktorë të tjerë, nëpërmjet autoritetit të saj ligjor dhe teknik.

Ndër detyrat funksionale të përcaktuara në aktet ligjore të lartpërmendura për AKUM, janë:

- Përgatitja e planeve dhe nevojave për investime për ndërtimin/rehabilitimin/zgjerimin/përshtatjen e sistemeve dhe infrastrukturës së plotë të UK-së, si dhe planifikimin territorial respektiv, planifikimin e nevojave dhe implementimin e tyre për investime dhe planifikimin territorial në infrastrukturën e mbetjeve, si dhe për implementimin e tyre, bazuar në programet e qeverisë, masterplanet kombëtare sektoriale dhe dokumenta të tjerë strategjik në sektorët respektiv;
- Koordinon, nxit dhe bashkëpunon me institucionet shtetëror të nivelit qendror dhe lokal, institucionet financiare ndërkombëtare, investitorët dhe palët e tjera të interesuara sipas kuadrit ligjor, për zbatimin e strategjive të sektorit për shërbimet e ujësjellës-kanalizimeve, trajtimin të ujrave të ndotura dhe planifikimin territorial si dhe infrastrukturën e mbetjeve;
- Përgatit metodologjinë dhe realizon shpërndarjen e subvencioneve të planifikuara në buxhetin e shtetit në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi;
- Është institucion përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e procedurave dhe të programit të monitorimit për shërbimet e furnizimit me ujë, të kanalizimeve dhe trajtimin të ujrave të ndotura si dhe infrastrukturën e mbetjeve;
- Ka të drejtë të jetë pjesë e subjektit të kompetencave të përbashkëta, sipas përcaktimeve të ligjit të vetëqeverisjes vendore;
- E të tjera”.

Për situatën e krijuar nga ndërtimet pa kriter në zonën në fjalë, Institucioni i Avokatit të Popullit, vlerëson se është përgjegjësi dhe neglizhencë e organeve qendrore dhe vendore, të cilët duhet të kishin marrë të gjitha masat e duhura për të kontrolluar dhe monitoruar territorin.

Sigurisht edhe banorët që kanë kryer ndërtime informale kanë përgjegjësinë e tyre, por tashmë pas 20 vitesh situata duhet të nisë të sistemohet.

Sa më sipër, ushtrimi i detyrave tuaja funksionale dhe marrja e masave të menjëhershme për garantimin e një mjedisi të shëndetshëm, përbën nevojë emergjente duke patur parasysh dhe Direktivën Kuadër për Ujërat (2000/60/EC) dhe Direktivën për Trajtimin e Ujrave të Ndotura Urbane (91/271/EEC) që synojnë mbrojtjen e shëndetit të njeriut.

Më tej duke u fokusuar në njohjen e standardeve ndërkombëtare, theksojmë faktin se Rezoluta 64/292 e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, njeh të drejtën për ujë të pijshëm dhe kanalizime të sigurta dhe të pastërta, si një ‘e drejtë e njeriut’ që

është thelbësore për gëzimin e plotë të të gjitha të drejtave; Asambleja e Përgjithshme⁴ u bën thirrje Shteteve dhe organizatave ndërkombëtare që të ofrojnë burime financiare, ngritje kapacitetesh dhe transferim teknologjie, nëpërmjet ndihmës dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, veçanërisht për vendet në zhvillim, në mënyrë që të shtojnë përpjekjet për të siguruar ujë të pijshëm dhe kanalizime të sigurta, të pastërta, të aksesueshme për të gjithë.

Shqipëria është një nga vendet që ka nënshkruar Deklaratën e Mijëvjeçarit duke u angazhuar në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit deri në vitin 2015. Dhe në shtatëmbëdhjetë Objektiva për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZHQ), të cilat kanë si afat vitin 2030. Në këtë axhendë të re të zhvillimit, uji dhe kanalizimet konsiderohen të kenë rol kyç në të gjitha dimensionet e zhvillimit të qëndrueshëm, për sa ato kanë lidhje me disa probleme kryesore globale dhe kanë ndikim në të gjitha aktivitetet njerëzore.

Ndër të tjera, për herë të parë në historinë e saj, Kombet e Bashkuara kanë pranuar se kushdo, kudo, ka të drejtë të jetojë në një mjedis të pastër, të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm⁵. Rezolutat nga Këshilli i të Drejtave të Njeriut në 2021 (A/HRC/RES/48/13) dhe Asambleja e Përgjithshme në 2022 (A/RES/76/300) e shtojnë këtë të drejtë themelore të njeriut në bibliotekën e të drejtave të njohura ndërkombëtarisht. *“Ndërsa njerëzimi përballë me një krizë planetare të paprecedentë, është shpresa jonë e vërtetë që e drejta për një mjedis të pastër, të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm do të shërbejë si një katalizator për ndryshimet sistematike dhe transformuese për të prodhuar një të ardhme të drejtë dhe të qëndrueshme në harmoni me natyrën”.*

Po ashtu Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e ka paraparë të drejtën e një mjedisi, *“për një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm”* si synim të objektivave sociale dhe përgjegjësi të shtetit, brenda kompetencave të tij.

Në këtë drejtim, shëndeti i njeriut mund të shihet si urë domethënëse midis të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes së mjedisit, duke qenë objektivi parësor i të dy fushave të rregullimit. Të drejtat e njeriut ekzistojnë për të promovuar dhe mbrojtur mirëqenien njerëzore, për të lejuar zhvillimin e plotë të secilit person dhe maksimizimin e qëllimeve dhe interesave të personit, individualisht dhe në bashkësi me të tjerët. Parakusht për shëndetin janë mjedise të sigurta, p.sh ajri, uji dhe toka. Ndotja ndikon në klimë, e cila nga ana tjetër fillon me një sër reagimesh që rezultojnë në fatkeqësi natyrore. Ai shkatërron shëndetin dhe vret, kështu që jo vetëm që shkatërron mjedisin, por shkel edhe të drejtat e njeriut.

Duke e trajtuar këtë çështje në një këndvështrim më specifik, eidentojmë se Bashkia Sarandë, ushtron në përputhje me legjislacionin në fuqi, funksionet dhe kompetencat (të njohura ndryshe si “Funksione të veta”), që ajo gëzon si njësi bazë e vetëqeverisjes vendore, nga ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

⁴ <https://digitallibrary.un.org/record/687002?ln=en>

⁵ <https://ëëë.ohchr.org/en/special-procedures/sr-environment>

Kjo bashki është përgjegjëse për realizimin e këtyre funksioneve (ushtrimin e kompetencave), si dhe ka lirinë dhe autoritetin të marrë vendime e të përdorë mjete për këtë qëllim, brenda hapësirës së normave, kritereve dhe standardeve të pranuar përgjithësisht me ligj, duke zotëruar autoritet të plotë administrativ, për të kryer shërbime, investime dhe rregullime.

Një ndër funksionet e veta të Bashkisë Sarandë në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, në përputhje me përcaktimin e dhënë në neni 23, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, është; *“...bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për: Prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm, mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura, mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut dhe mbrojtjen nga përmbytjet në zonat e banuara...”*

Njësitë e vetëqeverisjes vendore mbështeten në veprimtarinë e tyre të përditëshme pikërisht në konceptin e *autonomisë vendore*, të kuptuar si, *“... e drejta dhe aftësia e njësitë të qeverisjes vendore, të krijuara sipas Kushtetutës dhe këtij ligji dhe në kuadër të kufizimeve të tij, që të rregullojnë dhe të administrojnë një pjesë thelbësore të çështjeve publike nën përgjegjësinë e tyre dhe në interes të bashkësisë”*, siç parashikohet në nenin 2/2, të ligjit nr.139/2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”*.

Një rol të rëndësishëm në ushtrimin e kompetencave për mirëmbajtjen e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe të impianteve të pastrimit të tyre, luan edhe Shoqëria Rajonale Ujësjellës-Kanalizime sh.a Sarandë, e cila ka si mision të punës së saj, përmirësimin e menaxhimit në Sektorin e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve në atë zonë, për ta bërë atë më eficient, të qëndrueshëm dhe efektiv në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Për sa më sipër, Avokati i Popullit, vlerëson se Bashkia Sarandë, nëpërmjet Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime sh.a Sarandë, është autoriteti përgjegjës për furnizimin me ujë të pijshëm dhe trajtimin e ujërave të ndotura. Sipas VKM-së nr. 1304, datë 11.12.2009 *“Për furnizimin me ujë dhe kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës kanalizime sh.a”*, përcaktohet qartë se Bashkia, ngarkon për funksionim dhe mirëmbajtje një shoqëri publike të licensuar nga Enti Rregullator Kombëtar i Ujit për shërbimet e ujësjellës kanalizimeve. Bashkitë që posedojnë 100% aksione të kësaj shoqërie, me anë të asamblesë së aksionerëve realizojnë vendimmarrjet e rëndësishme për UK sh.a, përcaktojnë natyrën dhe qëllimin e ndërmarrjes si edhe datën e zbatimit, zgjerimin ose riorganizimin e saj.

Ujësjellës Kanalizime sh.a Sarandë përfaqëson institucionin funksional dhe ekzekutiv që vepron në emër të Bashkisë Sarandë dhe që ka detyrimet dhe përgjegjësitë publike për shërbimet e furnizimin me ujë dhe të kanalizimeve të ujërave të ndotura në qytetin.

Pra, të gjitha këto akte ligjore dhe nënligjore kërkojnë dhe kanë si kusht ushtrimin e detyrave tuaja funksionale dhe marrjen e masave të menjëhershme për zgjidhjen afatgjatë të problemit të ujërave të ndotura në zonën e fshatit Qafë Gjashtë, Sarandë, në përputhje

me standardet e kërkuara dhe si një nevojë emergjente për të mos çenuar në asnjë rast shëndetin e këtyre qytetarëve.

Çështja e mbrojtjes së mjedisit ka qenë në vëmendjen e vazhdueshme të institucionit të Avokatit të Popullit. Problematika që prezantohet në këtë kronikë është tepër serioze në drejtim të shëndetit të qytetarëve dhe megjithëse ekziston prej disa kohësh ende nuk janë marrë masat e duhura për të arritur rezultate konkrete në drejtim të garantimit me cilësi të këtij shërbimi publik.

Për sa më sipër, nga informacioni i prezantuar për këtë çështje del e qartë se, zonën e fshatit Qafë Gjashtë, Sarandë,, ndodhet mes ndotjes së ujërave të zeza. Ndër të tjera, situata bëhet më problematike, duke marrë parasysh faktin se zona është e banueshme nga një komunitet i gjerë njërëzish.

Duke analizuar specifikën e këtij rasti dhe korespondencën zyrtare të dërguar nga ana e subjekteve shtërëror gjykojmë se është thelbësore ndërmarrja e veprimeve konkrete dhe planifikimi i investimeve në infrastrukturë për zgjidhjen e situatës së krijuar e cila do të ndikonte në uljen e rrezikut të efekteve serioze në shëndetin publik dhe mjedisit në tërësi.

Në analizë të fakteve të mësipërme, institucioni i Avokatit të Popullit synon që jo vetëm të vërë në lëvizje organet kompetente, por dhe t'i sensibilizojë ato për vetë rëndësinë që ka kjo problematikë, ndaj ne theksojmë marrjen e veprimeve konkrete për zgjidhjen përfundimtare të problemit sikundër është menaxhimi i ujërave të ndotura të cilat kanë ndikime negative në ekosistem dhe turizëm.

Në këtë kuadër, duke patur parasysh se kjo është një çështje e rëndësishme për qytetarët, të cilëve duhet ti grantohet e drejta për një mjedis të shëndetshëm dhe kanalizime, Avokati i Popullit dëshiron të sjellë në vëmendjen tuaj ushtrimin e detyrave funksionale dhe marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin e situatës së krijuar përmes investimeve në infrastrukturën e kanalizimeve në zonën e fshatit Qafë Gjashtë, Sarandë,.

Në ushtrim të detyrës për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj, si dhe nxitjes së standarteve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend, Institucioni i Avokatit të Popullit, bazuar në parashikimet e ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, "*Për Avokatin e Popullit*", të ndryshuar, ligjin nr. 139/2015, "*Për vetëqeverisjen vendore*", gjen me vend të adresojë pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit si dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, zgjidhjen e çështjes së prezantuar, në kushtet kur njësia e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Sarandë, nuk zotëron fonde apo mjetet e mjaftueshme për arritjen e standartit dhe normave kombëtare për mbrojtjen e mjedisit.

Referuar parashikimeve të nenit 23/2 të ligjit nr. 139/2015, "*Për vetëqeverisjen vendore*", Bashkia, Sarandë, është përgjegjëse në territorin e juridiksionit të vetë, për mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura, dhe se në kuptim dhe zbatim të parashikimit të kryer në nenin 30/6 të ligjit në fjalë, qeverisja qendrore garanton njësitë të

vetëqeverisjes vendore, mbështetjen e nevojshme financiare për ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të deleguara.

Gjithashtu, Avokati i Popullit, konsideron se roli i këtyre institucioneve në evidentimin e problematikave dhe dhënien e zgjidhjeve duhet të jetë proaktiv e të garantojë njohjen e situates në terren.

Praktika e derisotme për zgjidhjen e çështjeve të tilla, tregon se, në pamundësi të mbështetjes së nevojshme financiare nga Buxheti i Shtetit, Këshilli i Ministrave, rast pas rasti, ka kryer lidhjen e marrveshjeve për financimin e projekteve mbi bazë të të cilave është zgjidhur problemi i mbledhjes, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura.

Për sa më sipër, për të gjitha arsyet që parashtuam, bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit ka drejtë të bëjë rekomandimet dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga Administrata Publike...”*, si dhe në bazë të Nenit 21/b të ligjit Nr.8454/1999 *“Për Avokatin e Popullit”* (me ndryshimet përkatëse), ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*:

REKOMANDOJMË

- Marrjen e masave të menjëhershme për planifikimin në buxhet për ndërtimin e një sistemi të ri kanalizimesh në zonën e fshatit Gjashtë, Sarandë, me qëllim zgjidhjen përfundimtare të situatës së krijuar e cila do të ndikonte në uljen e rrezikut të efekteve serioze në shëndetin publik dhe mjedisit në tërësi;
- Marrjen e masave të menjëhershme për ndërtimin e sistemit të kanalizimeve të ujërave të zeza në zonën e fshatit Qafë Gjashtë, Sarandë;
- Marrjen e masave për aplikuar në progame të ndryshme ndërkombëtare që ofrojnë mbështetje për trajtimin e ujërave të ndotura.
- Marrjen e masave prej Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për mbështetjen e nevojshme financiare të Bashkisë, për mbështetjen e nevojshme financiare të Bashkisë Kamëz, për mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura në zonën e fshatit Qafë Gjashtë, Sarandë,.

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr.8454 datë 4.02.1999, *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, lutemi na ktheni përgjigje të argumentuar brenda afatit 30 ditor lidhur me masat ligjor dhe qëndrimin që do të mbani ndaj këtij rekomandimi,

Duke besuar në bashkëpunimin tuaj,

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

KOMISIONERI

Ahmet PRENÇI

Konc dhe Dak
A Gjoleka
Datë 11.10.2023